

# Punësimi dhe jetesa në Gjermani

Informacione në lidhje me lejën e qëndrimit, përkitazi parakushteve dhe procedurave për nënshtetasit dhe nënshtetasit e Republikës së Shqipërisë



**Bundesagentur für Arbeit**

Zentrale Auslands-  
und Fachvermittlung (ZAV)

## **A mendoni të ndërtoni një të ardhme në Gjermani?**

**Me këtë broshurë ne duam t'iu informojmë mbi mundësitë për të përfituar një leje qëndrimi për punë në Gjermani dhe cilat kritere duhet të plotësoni për këtë.**



# 1. Qasja Juaj në tregun gjerman të punës përmes rregulloreve të reja

Për shkak se Republika e Shqipërisë është kategorizuar në Gjermani si një i ashtuquajtur „vend i sigurtë origjine“, kërkesat për azil të nënshtetasve nga Shqipëria faktikisht nuk kanë pothuajse asnjë shans të njihen. Prandaj pjesa dërrmuese e azilkerkuesve, të cilët vijnë nga Republika e Shqipërisë duhet të kthehen sërish në atdheun e tyre.

Me efekt ligjor nga data 28.10.2015 janë lehtësuar kriteret ligjore për futjen në tregun gjerman të punës të qytetareve dhe qytetarëve nga Republika e Shqipërisë: Nga data 01.01.2016 e deri më datën 31.12.2020 qytetarët e qytetarët nga Republika e Shqipërisë kanë mundësi të marrin një leje qëndrimi në Gjermani për të gjitha **profesionet e punës, shkollimet profesionale, e punë të tjera ndihmëse**. Kjo vlen edhe atëherë kur Ju nuk keni një shkollim të caktuar profesional, apo kur kualifikimi Juaj profesional nuk njihet në Gjermani. Nga kjo rregullore përjashtohen rastet e punëmarrëseve dhe punëmarrësve të huazuar.

## Cilat janë kushtet që duhet të plotësohen nga ana Juaj?

- Ju keni një ofertë për një vend të garantuar pune nga ana e një Punëdhënësi në shtetin e Gjermanisë për më datën 01.01.2016 apo për më vonë.
- Ju i përmbushni kushtet ligjore të parapara për lëshim vize.

## Si duhet të procedoni më tutje?

Ju mund ta përshpejtoni procedurën e vizës, në qoftë se Ju i përcillni këto udhëzime si në vijim:

Para se Ju të aplikoni për lëshim vize pranë përfaqsisë së Juaj të jashtme Gjermane, **punëdhënësi i Juaj** mund të lejë të verifikohen rrethanat e Juaja nga ana e Organit përkatës në shtetin e Gjermanisë.

Partneri i parë i bisedës përgjat asaj është ose Organi për nënshtetasit e huaj ose Agjencia Federale për Punësim:

---

a) A keni qëndruar ndonjëherë më parë në shtetin e Gjermanisë (p.sh. me leje të qëndrimit, Blue Card, leje të vendosjes, etj., ose si parashtrues kërkesë azili me leje tolerimi (Duldung) ose me leje qëndrim)? Atëher **punëdhënësi** i Juaj ju drejtohet **organit për nënshtetasit e huaj** me kompetencë rajonale me një ofertë të garantuar vendi pune. Organi për nënshtetasit e huaj do të verifikon qëndrimet e Juaja të mëparshme në shtetin e Gjermanisë.

## UDHËZIM

Nënshtetasit e Shqipërisë, Bosnjes dhe Hercegovinës, Kosovës, Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë, të cilët do të aplikojnë për lëshim vizë për punësim bazuari në rregulloret e reja ligjore, nuk është e lejuar të kenë pranuar kontribute (pagesa) bazuari në ligjin mbi kontributet për parashtrues kërkesë azili në shtetin e Gjermanisë brenda një afati prej 24 muajsh para ditës së aplikimit.<sup>1</sup>

Organi për nënshtetasit e huaj merrë miratimin nga **Agjencia Federale për Punësim (AF)**: Atje do të verifikohet, se a qëndrojnë në dispozicion për ofertën e vendit të punës kandidatë apo kandidat të favorizuar<sup>2</sup>. Në një rast te tillë Ju nuk do të pranoni një leje për tregun Gjerman të punës. Përveq kësaj me lartë, AF do të verifikoj gjithashtu edhe rrethanat e marrëdhënies së punës, e veçanërisht pagën dhe orarin e punës, sepse të tillat duhet ti përkasin standardeve të cilat janë të zakonshme në Gjermani.

Në qoftë se janë përbushur të gjitha parakushtet, **punëdhënësi i juaj gjerman** do të pranojë një miratim **paraprak për lëshim vize** nga Organi për nënshtetasit e huaj.

**Pas pranimit të atij miratimi paraprak Ju mund të parashtroni një kërkesë për lëshim vize pranë Ambasadës.**

---

<sup>1</sup> Me përjashtim të nënshtetasve nga Republika e Shqipërisë, të cilët pas datës 1. Janar 2015 dhe para datës 24.10.2015 kanë parashtruar në shtetin e Gjermanisë kërkesën për njohjen e të drejtës së azilit, po ashtu më datën 24.10.2015 gjendeshin në Gjermani, dhe pas datës 24.10.2015 janë larguar pa asnjë vonesë nga ky vend. Për këtë grup personash është e mundur rihyrja në Gjermani prej datës 01.01.2016, për sa kohë përbushen kriteret e mëposhtme dhe organi përkatës i shtetit gjerman për nënshtetasit e huaj e miraton rihyrjen në Gjermani.

<sup>2</sup> Këtu bëjnë pjesë nënshtetasat dhe nënshtetasit nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, nga Islanda, Liechtenstein-i, Norvegjia apo nga Zvicra, si dhe nga anëtarë tjerë të të ashtuquajturave shtete të treta me një qasje të pakufizuar në tregun e punës.

b) A keni qëndruar asnjëherë apo vetëm për një afat të shkurtër në shtetin Gjerman para aplikimit (këtu është fjala për qëndrimet, për te cilat Ju keni patur nevojë të mirrni një vizë nga përfaqësia e jashtme e shtetit Gjerman)? Atëher nuk është e patjetrësueshme të mirret një miratim përkitazi lëshimit të një vize për Ju nga ana e Organit gjerman për nënshtetasit e huaj. Punëdhënësi i Juaj gjerman në një rast të tillë ju drejtohet me një ofertë të garantuar vendi pune drejtëpërsëdrejti Agjencisë Federale për Punësim, e cila më pastaj do të zbatojë verifikimet veqse të përshkruara më lartë.


Në qoftë se janë përmbushur të gjitha parakushtet, atëher **punëdhënësi i Juaj** do të pranon një **miratim paraprak për lëshim** vize nga AF.

**Pas pranimit të atijë miratimi paraprak Ju mund të parashtroni pranë Ambasadës një kërkesë për lëshim vize.**

## PARTNERI BISEDËS

---

Një pasqyrë aktuale me partnerët kompetentë të bisedës pranë Agjencisë Federale për Punësim Ju mund ti gjeni në Internet:

 **[www.arbeitsagentur.de](http://www.arbeitsagentur.de)**  
> Bürgerinnen & Bürger > Arbeit und Beruf > Arbeits-/Jobsuche > Arbeit in Deutschland > Arbeitsmarktzulassung



Thjeshtë skenoni QR-Code me Smartphon-in e Juaj.

## UDHËZIM

---

Ambasada e Republikës Federale të Gjermanisë  
Rruga Skënderbej, nr. 8  
1000 Tiranë

 **[www.tirana.diplo.de](http://www.tirana.diplo.de)**

---

---

## 2. Rrugët e marrjes së lejes së punësimit për aplikueset dhe aplikuesit me kualifikim të veçantë.

Verifikimi i përshkruar në kapitullin paraprak mbi përparësinë që gëzojnë kërkesat e kandidatëve apo kandidatëve gjermanë dhe ata evropianë nuk kryhet, në qoftë se Ju keni kualifikime të veçanta pune si më poshtë:

### **Ju jeni akademike/akademik:**

Ne qoftë se Ju keni një diplomë universiteti dhe ju ofrohet një kontratë pune nga ana e një punëdhënësi në shtetin e Gjermanisë për një pozicion pune, i cili përputhet me diplomimin Tuaj, atëherë është e mundur që Ju të merrni një të ashtuquajtur „**Blaue Karte EU**“ (**Karta Blu e BE-së**). Në lidhje me këtë së pari duhet të verifikohet se a mund të krahasohet diplomimi Juaj universitar me një diplomim nga një universitet në shtetin e Gjermanisë. Po ashtu kusht është paga minimale vjetore bruto prej 48.400 €<sup>3</sup>.

Në qoftë se Ju keni një diplomë universiteti në një profesion pune, për të cilin aktualisht ka kërkesë të lartë në shtetin e Gjermanisë (studiuese/studiuues i sh-

kencave natyrore, matematiciene/matematicien, inxhinierë/inxhinier, mjek/mjek, dhe profesionistë me shkollim të lartë për teknologjinë e informacionit- dhe komunikacionit) dhe njëherazi ju ofrohet një kontrate pune, atëherë Ju mund të aplikoni për „Blaue Karte EU“ – (Kartën Blu të BE-së) prej një page minimale vjetore 37.752€.<sup>4</sup>

Personat që kanë Kartën Blu të BE-së kanë mundësi që pas një qëndrimi 33 muajsh, respektivisht pas vërtetimit të njohurive të mjaftueshme mbi gjuhën gjermane pas 21 muajsh, të marrin një leje vendosje.

### **Ju jeni punëtor i kualifikuar:**

Ekzistojnë një sërë kualifikimesh profesionale për punë, të cilat në Gjermani nuk arrihen nëpërmjet një studimi në universitet, por përmes kualifikimit profesional në një ndërmarrje pune. Në një pjesë dërrmuese të këtyre profesioneve kërkohet fuqi punëtore e kualifikuar. Qasja në tregun e punës për ata që kër-

---

<sup>3</sup> Shumat ndryshojnë për çdo vitë. Kjo shumë vlenë për vitin 2015. Në vitin 2016 vlenë një pagë minimale vjetore prej 49.600 €. (Gjendja: 01.12.2015).

<sup>4</sup> Shumat ndryshojnë për çdo vitë. Kjo shumë vlenë për vitin 2015. Në vitin 2016 vlenë një pagë minimale vjetore prej 38.688 €. (Gjendja: 01.12.2015).

kojnë punë nga shtetet jashtë Evropës është lehtësuar në lidhje me këto profesione pune. Se cilat profesione i takojnë kësaj kategorie verifikohet çdo vit dhe publikohet në këtë adresë interneti:



➔ [www.make-it-in-germany.com/en](http://www.make-it-in-germany.com/en)

> for qualified professionals  
> working > demanded professions > needed vocational qualifications

Aktualisht (Gjendja: Nëntor 2015) janë radhitur mbi 130 profesione pune gjithsej, veçanërisht në sektorin e shëndetësisë- dhe të kujdesit mjekësor, në profesione si mekatronik- dhe elektrikist, ndërtimtari – dhe profesione të tjera teknike, si edhe profesione nga sektori i komunikacionit rrugor dhe i logjistikës.

Në qoftë se Ju vini nga një prej këtyre profesioneve dhe njëherazi posedoni një ofertë të garantuar vendi pune, Ju mund të merrni një vizë për fillimin e një marrëdhënie pune dhe atë në qoftë se Agjencia Federale e Punësimit vërteton faktin, që rrethanat e punësimit Tuaj në atë vend pune i përkasin rrethanave të njëjta të punëmarrësve tjerë me prejardhje gjermane.

Për aplikimin për leje qëndrimi duhet të verifikohet gjithashtu, nëse kualifikimi

Juaj profesional është i krahasueshëm me një kualifikim profesional pune përkatës në shtetin e Gjermanisë. Ju lutemi të mirrni në konsideratë, që Ju nga vendi i Juaj duhet të inicijoni këtë procedurë. Informacionet në lidhje me këtë Ju mund t'i gjeni në gjuhën gjermane dhe në gjuhën angleze në faqet e internetit: ➔ [www.anerkennung-in-deutschland.de](http://www.anerkennung-in-deutschland.de) dhe ➔ [www.berufliche-anerkennung.de](http://www.berufliche-anerkennung.de).

Në qoftë se qendra përkatëse e certifikimit përcakton se për të arritur ekuivalencën e diplomimit Tuaj janë të nevojshme kualifikime të mëtejshme, Ju nën rrethanat të caktuara mund të aplikoni për një titull leje qëndrimi përkitazi certifikimit të kualifikimit të Juaj profesional. Si fuqi punëtore e kualifikuar apo si akademik/e, Ju mund të aplikoni për lëshimin e vizës drejtpërsëdrejti pranë përfaqsisë së jashtme Gjermane.

**Pyetje të tjera?** Për fuqi punëtore të kualifikuara dhe për ata me shkollim të lartë ju rekomandojmë të shikoni portalin e mirësearchjes „Make it in Germany“: Fuqitë punëtore nga vende të ndryshme me kualifikim profesional mund të gjejnë këtu informacione mbi shanset e punësimit dhe karrierëa në Gjermani – si edhe arsyet pse ia vlen të jetohet dhe punohet këtu.



---

### **Jobseeker-Viza (Vizë për të kërkuar një vend pune)**

Qasja në tregun e punës nëpërmjet të ashtuquajturës „Blaue Karte EU“ (Karta Blu e BE-së) apo të listës pozitive e ka si parakusht ofertën e një vendi pune. Në qoftë se Ju keni një diplomë universiteti të njohur nga shteti i Gjermanisë apo një shkollim të lartë universitar të

krahasueshëm me një gjerman, atëherë keni mundësi të aplikoni për një vizë për të kërkuar punë edhe pa pasur ofertë konkrete pune. Me këtë vizë për të kërkuar këtu një vend pune ju mund të hyni dhe qëndroni deri në gjashtë muaj në shtetin e Gjermanisë. Kusht për këtë është që Ju për atë periudhë kohe të jeni në gjendje të financoni jetesën Tuaj edhe pa punuar.

## **3. Parapërgatitja**

### **Mësoni gjuhën gjermane**

Kush kërkon vend pune, por edhe kush aplikon për vend pune duhet të zotërojë **gjuhën gjermane** në nivelin e duhur. Të mundshme janë edhe **kurset e gjuhës** në Institutin “Goethe” në atdheun e juaj. Faqja e „Deutsche Welle“-s ju ofron në internet kurse falas për gjuhën.

Informacione të tjera mbi mësimin e gjuhës gjermane dhe në lidhje me kurset e gjuhës Ju mund t'i gjeni gjithashtu edhe në faqën e internetit ➞ [www.make-it-in-germany.com](http://www.make-it-in-germany.com)

### **Përgatisni dëftesat dhe vërtetimet e duhura**

Gjasat më të mira për një vend pune në Gjermani i kanë ato kandidatë apo ata kandidatë, të cilët kanë kualifikim të mirë profesional.

Ne qoftë se Ju jeni i diplomuar në një profesion apo keni mbaruar universitetin, Ju me siguri do të jeni në gjendje të dorëzoni bashkë me kërkesën, edhe të gjitha dëftesate duhura. Në qoftë se Ju jeni akademike/akademik apo fuqi punëtorë e kualifikuar dhe njëherazi i plotëso-

ni kushtet e përshkruara më gjerësisht nën pikën 2, do të ishte mirë që Ju të parashtroni një kërkesë për njohjen e kualifikimit Tuaj profesional që në vendlindje.

### Si mund të gjeni një vend pune

Të gjitha ofertat e shpalluara për punë publikohen nga Agjencia Federale e Punësimit në faqën e internetit [↪ jobboerse.arbeitsagentur.de](https://jobboerse.arbeitsagentur.de). Qendra për Ndërmjetësimin me Jashtë dhe atë Profesional (ZAV) e Agjencisë Federale për Punësim dhe qendra "Make it in Germany – Migration Support Center" ju ndihmojnë me shërbime të ndryshme gjatë kërkimit të vendit të punës: **+49 228 713 1313** ose [zav@arbeitsagentur.de](mailto:zav@arbeitsagentur.de).

Natyrisht edhe portalet me oferta pune, si [↪ www.stepstone.de](https://www.stepstone.de) ose [↪ www.monster.de](https://www.monster.de) janë një mundësi e mirë për kërkimin e vendit të punës. Në faqen e internetit [↪ www.zeitung.de](https://www.zeitung.de) dhe [↪ www.onlinenewspapers.com](https://www.onlinenewspapers.com) Ju mund të gjeni një përmbledhje të të

gjitha gazetave mbirajonale dhe rajonale në shtetin e Gjermanisë. Ju gjithashtu mund të shikoni edhe në faqet e internetit të disa prej këtyre gazetave për oferta pune, të cilat janë të publikuara në to. Në portalin e internetit [↪ ec.europa.eu/eures](https://ec.europa.eu/eures)

Ju mund të kërkoni po ashtu për oferta pune në shtetin e Gjermanisë.

### Si mund të aplikoni

Kërkesës së suksesshme për vend pune i paraprin përgatitja e duhur e dokumentacionit për aplikim. Informacionet në lidhje me modalitetet e ndryshme të aplikimit në shtetin e Gjermanisë Ju mund t'i gjeni në faqen e internetit [↪ make-it-in-germany.com/en](https://make-it-in-germany.com/en) > Working > Guide. Faqja e internetit [↪ www.europass-info.de](https://www.europass-info.de) ofron modelet e duhura për një aplikim bazuar në standardet evropiane përfshirë biografinë, pasaportën e gjuhës, dhe një model për prezantimin e kualifikimeve profesionale për punë, si edhe një të ashtuquajtur „Diploma Supplement“ për diplomimin akademik.

---

## Ne rast se familja juaj vjen me Ju

Ata, të cilëve iu është dhënë një leje pune- dhe qëndrimi për shtetin e Gjermanisë, **gëzojnë të drejtën të sjellin më pas gjithashtu edhe pjesëtarët e afërm të familjes (bashkëshortin/bashkëshorten dhe/ose fëmijët, të cilët i takojnë moshës së mitur)**, kjo në qoftë se ata kanë hapësirë të mjaftueshme banimi, si edhe nëse janë në gjendje të sigurojnë kostot e jetesës për familjen e tyre, pa pasur nevojë të shfrytëzojnë përkrahjen e shtetit. Gjithashtu edhe pjesëtarët e afërm të familjes parimisht kanë nevojë vize për hyrje në shtetë. Kjo rregullore **i mundëson sipas ligjit gjithashtu edhe bashkëshortit apo bashkëshortes të kenë drejtë punësimi këtu.**

Pas hyrjes në Gjermani, pjesëtarët e familjes Suaj janë të detyruar të paraqiten dhe regjistrohen pranë organit për regjistrimin civil dhe njëherazi të parashtrajnë edhe një kërkesë pranë organit përkatës për nënshtetasit e huaj për lëshimin e lejes së qëndrimit.



## A KENI ENDE PYETJE TË TJERA?

Sa i përket pyetjeve në lidhje me kushtet e jetesës- dhe të punësimit në shtetin e Gjermanisë, Ju mund të ju drejtoheni qendrës "Make it in Germany – Migration Support Center" të qendrës për ndërmjetsim me shtete të jashtme dhe ndërmjetsim profesional (ZAV) të Agjencisë Federale për Punësim nën numrin: **+ 49 228 713 1313** ose nën faqen e internetit **[zav@arbeitsagentur.de](mailto:zav@arbeitsagentur.de)**.

Gjithashtu edhe të dy portalet e informacionit [⇒ ec.europa.eu/eures](https://ec.europa.eu/eures) dhe [⇒ www.make-it-in-germany.com](https://www.make-it-in-germany.com) ju informojnë si duhet në lidhje me kushtet e jetesës- dhe të punësimit, standardet e aplikimit, sigurimit social, tatimet dhe në lidhje me shumë tema të ndryshme, të cilat janë të rëndësishme për parapërgatitjen e punësimit në shtetin e Gjermanisë.

Nëse keni pyetje në lidhje me hyrjen në Gjermani, lejen e punës dhe lejen e qëndrimit Ju lutemi drejtohuni më së miri pranë Ambasadës Gjermane në vendin Tuaj.

**Botuese**

Agjencia Federale për Punësim

90327 Nürnberg

Qendra për Ndërmjetësimin me Jashtë  
dhe atë Profesional

Nëntor 2015

**[www.arbeitsagentur.de](http://www.arbeitsagentur.de)**

Shtypi: ditges print+more GmbH  
Lindenstraße 78, 53721 Siegburg



Thjeshtë skenoni QR-Code me  
Smartphon-in e Juaj.